



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranimi / Prizemirje Received / Prizemirje Received / Delivery	04.03.2021	viti year
Organ / Organa Organization / Organa	No. Pror. to Pror. Pror. No.	Sasia Kolicitimi Quantity
SKPM&K	979/2021	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.73/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.73/2021 të datës 12.02.2021, të parashtruar nga _____ të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Sheremet _____ ne adresë banimi Rr“Afrim Zhitia”, pn, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Universiteti i Mitrovicës ”Isa Boletini“, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.73/2021 të datës 12.02.2021 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesit _____ i punësuar në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” sipas Akt emërimit të datës 26.04.2016 në pozitën Zyrtar për Analiza Laboratorike në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit _____ ka parashtruar ankesë me numër protokollit 615/2021 të regjistruar me numër A.nr.73/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagës bazë për 30% dhe ngritjes së pagës bazë për 25% sipas rritjes së pagës bazë për 30% sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.03/177 të datës 14.03.2014.

Me datën 25.11.2020 ankuesi ka parashtruar ankesë me nr.1837, përmes përfaqësuesit avokatit _____ te Këshilli Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për kompensimin e diferencës së të ardhurave personale. Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” me vendimin e datës 29.01.2021 me numër protokollit 163 ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me vendimin e datës 29.01.2021 me numër protokollit 163 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” me datën 12.02.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit _____ ka parashtruar ankesë me numër protokollit 615/2021 të regjistruar me numër A.nr.73/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.02.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Universitetit i Mitrovicës "Isa Boletini". Me datën 01.03.2021 Menaxherja e Personelit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" përmes e-mailit zyrtar ka dërguar përgjigjen në ankesë bashkë me provat e lëndës faqe 1/11.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 615/2020 të datës 12.02.2021 e parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit avokatit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 09.10.2020 i avokatit Ankesë e datës 24.11.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Mitrovicës; Vendimi i datës 29.01.2021 me numër protokollit 163 i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"; Akt emërimi i datës 26.04.2016; Vendimi i datës 04.02.2021 me nr.212; Përgjigje për zbatim të vendimit të Këshillit me nr. A 02/139/2016 të KPMSHCK-së; Njoftimi i datës 16.01.2018 lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 01.03.2021 faqe 1/11.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", Vendimin e datës 04.02.2021 me nr.212, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: **4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike,** dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitetet Publike, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesit tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përkasin kategorisë së nëpunësve të **Shërbimit Publik**, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit, udhëzon palët për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 74 si dhe nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: **"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente".**

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.73/2021, datë 04.03.2021

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".
- Arkivit të KPMSHCK-së.